



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	233/20
Nr. i fq. / Br. sht	- 2 -
DATA: / Datum	26.11.2020
VUSHTRRI - VUÇITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

**RREGULLORE
(KKV) NR.09/2020 PËR SHFUQIZIMIN E RREGULLORES TË TATIMIT
NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2021**

Vushtrri nëntor 2020,

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), nenit 41, paragrafi 2 shkronja “d” të Statutit të Komunës të Komunës, nenit 12 i Rregullores MAPL 01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më **26 nëntor 2020** miraton këtë:

**RREGULLORE
PËR SHFUQIZIMIN E RREGULLORES TË TATIMIT NË PRONËN E
PALUAJTSHME PËR VITIN 2021**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është shfuqizimi i Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme të Komunës së Vushtrisë për vitin 2021.

**Neni 2
Shfuqizimi i Rregullores**

Me këtë rregullore shfuqizohet Rregullorja (KKV) Nr.07/2020 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2021 me numër të protokollit 185/20 e datës 24.09.2020.

**Neni 3
Përgjegjës për zbatim**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Nasuf Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

